



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

## **RAPORT ME REKOMANDIME**

### **I**

### **MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

### **LIDHUR**

### **ME VIZITËN NË BURGUN E SIGURISË SË LARTË**

**Për:**

- Z. Abelard Tahiri, Ministër  
Ministria e Drejtësisë**
  
- Z. Qemajl Marmullakaj, Sekretar i Përgjithshëm  
Ministria e Drejtësisë**
  
- Z. Uran Ismaili, Ministër  
Ministria e Shëndetësisë**
  
- Z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm  
Ministria e Shëndetësisë**
  
- Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës**
  
- Z. Milazim Gjocaj, Drejtor i Përgjithshëm për Shëndetësi në Burgje  
Ministria e Shëndetësisë**
  
- Z. Burim Buleshkaj, Drejtor  
Burgu i Sigurisë së Lartë**

**Prishtinë, më 25 nëntor 2019**

## HYRJE

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm: MKPT) i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 10 dhe më 16 korrik 2019, vizitoi Burgun e Sigurisë së Lartë (në tekstin e mëtejshëm: BSL).

Qëllimi i kësaj vizite që shqyrtimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, të dërguara përmes Raportit me rekomandime, pas vizitave në BSL më 17, më 21 dhe më 31 mars 2017, i cili ishte publikuar më 16 qershor 2017<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejshëm Raporti), si dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale (në tekstin e mëtejshëm: LESP), me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Në BSL akomodohen të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë. Kapaciteti zyrtar i BSL-së është për 390 të burgosur. Gjatë vizitës së realizuar nga MKPT-ja, aty ishin të akomoduar 153 të burgosur, prej tyre 24 të paraburgosur. Në BSL akomodohen të burgosurit e përkatësive të ndryshme etnike.

### **Përbërja e grupit monitorues**

1. Ekipi monitorues përbëhej si në vijim:

- Këshilltar i lartë juridik për parandalim të torturës.
- Këshilltare juridike për parandalim të torturës.
- Këshilltarja-mjeke
- Këshilltarja-psikologe
- Këshilltarja-punëtore sociale.

### **Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës**

2. Gjatë vizitës që MKPT-ja i bëri BSL-së, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (në tekstin e mëtejshëm: DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën, si dhe iu mundësua intervistimi i të burgosurve, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e zyrtarëve të DShB-së.

---

<sup>1</sup> Raport me rekomandime i MKPT-së për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë, i publikuar më 16 qershor 2017. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/01/31/raport-i-mkpt-per-viziten-ne-burgun-e-sigurise-se-larte/>.

## Keqtrajtimi fizik

3. Gjatë vizitës në BSL, MKPT-ja nuk mori ankesa për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues, si dhe për sjellje të personelit korrektues apo shëndetësor, e cila do të përbënte shkelje të dinjitetit të njeriut të të burgosurve. Përkundrazi, shumica dërmuese e të intervistuarve të të gjitha përkatësive etnike u shprehën në favor të një trajtimi shumë të mirë nga zyrtarët korrektues dhe nga personeli i DShB-së. Përveç kësaj, MKPT-ja vërejti se niveli i komunikimit interaktiv ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të të burgosurve është në nivel të kënaqshëm.

## Kushtet materiale

4. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.<sup>2</sup> Më tej ligji përcakton: *“Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar, duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme, ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, si dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë, lexim, ngrohje dhe ajrosje.”*<sup>3</sup> Për më shumë, ky ligj përcakton se lokalet nuk duhet të kenë lagështi, duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.<sup>4</sup>
5. Kushtet e akomodimit në BSL në përgjithësi janë shumë të mira dhe ofrojnë rehati për të burgosurit, të cilët janë të vendosur të vetëm në qeli. Të gjitha qelitë ofrojnë dritë natyrore të mjaftueshme, hapësirë të mjaftueshme, kanë TV, tualete të pastra dhe të burgosurit mund të bëjnë dushe sa herë që duan. Qelitë janë të pajisura me krevat, me çarçafë, me tavolinë, me karrige dhe me sistem të thirrjes.
6. MKPT-ja vëren se, në përgjithësi, kushtet e akomodimit në BSL janë në pajtim me LESP-në, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe me Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm: KPT). Sa i përket qasjes së personave me aftësi të kufizuara (edhe pse nuk kishte të tillë), të gjithë ashensorët ishin funksionalë, gjë që e mundëson qasjen e të burgosurve me aftësi të kufizuara.
7. Megjithatë, MKPT-ja vërejti se dyshemetë në pavijonet 1, 2, në stacionar dhe në pavijonin e pranimit janë dëmtuar dhe vazhdojnë të dëmtohen. Përmes Raportit, **MKPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente që të ndërmarrin veprime për t'i sanuar këto dëmtime.** MKPT-ja u njoftua nga drejtori i BSL-së se janë nënshkruar kontratat konkrete për t'i sanuar këto dëmtime dhe pritet që punimet të fillojnë së shpejti. **MKPT-ja kërkon nga BSL-ja që ta njoftojë lidhur me progresin e shënuar në këtë drejtim.**

<sup>2</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

<sup>3</sup> Ligji nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 3, paragrafi 2.

<sup>4</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 3.

## Ushqimi

8. LESP-ja përcakton se i dënuari ka të drejtë për ushqim të përshtatshëm me tri shujta për çdo ditë për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij, të cilat duhet të jenë të llojlojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, për aq sa është e mundur, duhet t'i përshtatet kërkesave të tij fetare dhe kulturore. Më tej ligji përcakton obligimin që të dënuarit t'i sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.<sup>5</sup> Po ashtu, LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurit që gjatë gjithë kohës të ketë në dispozicion ujë të pijshëm.<sup>6</sup>
9. Rregullat e Mandelës, që është një akt i rëndësishëm juridik ndërkombëtar për të drejtat e të burgosurve, përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurojnë ushqim adekuat për shëndetin e tyre, si dhe ujë të pijshëm gjatë gjithë kohës.<sup>7</sup> Në këtë drejtim, Rregullat Evropiane të Burgjeve po ashtu përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurojnë ushqim dietal, duke pasur parasysh moshën e tyre, gjendjen e tyre fizike, religjionin dhe natyrën e punës së tyre. Ndërsa ushqimi duhet të përgatitet dhe të shërbehet në kushte adekuate higjienike, kurse uji i pijshëm duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës.<sup>8</sup> **Shumica e të burgosurve nuk u ankuan sa i përket cilësisë dhe sasisë së ushqimit.**

## Regjimi

10. Sa i përket regjimit, BSL-ja ofron 3 regjime për të burgosurit: regjimi themelor, standard dhe i avancuar. Në BSL rreth **70 të dënuar** janë të angazhuar në punë. Në kuadër të BSL-së funksionon punëtorja e zdrukthëtarisë, në të cilën angazhohen në punë katër të dënuar dhe tash për tash aty prodhojnë shtretër për Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan. Punëtoritë e tjera tani për tani nuk mund të aktivizohen, për shkak të mungesës së pajisjeve dhe trajnerëve kompetentë.
11. Të burgosurit kanë të drejtë për së paku 2 orë shëtitjeje në ditë.<sup>9</sup> MKPT-ja vërejtur se në dispozicion të të dënuarve janë edhe pajisjet për lojëra të ndryshme, siç janë: ping-pongu dhe tavolina për të luajtur futboll. Një pjesë të kohës të dënuarit në pavijone të caktuara (varësisht nga regjimi) mund ta kalojnë duke qenë të lirë të lëvizin brenda pavijonit.
12. MKPT-ja mori ankesa nga të akomoduarit në pavijonin 1 dhe nga të paraburgosurit lidhur me regjimin. Sipas pohimeve të tyre, shumicën e kohës e kalojnë të mbyllur në qeli (rreth 22 orë) dhe kanë në dispozicion vetëm shëtitjet në ajër të pastër (dy orë në ditë). Nga intervistat me këta të dënuar dhe të paraburgosur mund të nxirret përfundimi se ata regjimin ndaj tyre e kuptojnë si regjim ndëshkues.
13. Fushat sportive janë të shtruara me beton me ngjyrë të bardhë, e cila pengon zhvillimin normal të aktiviteteve sportive, pasi që shkaktohen lëndime të shpeshta. Po ashtu shëtitoret janë të rrethuara nga muret e larta me të njëjtin material dhe ngjyrë, të cilat kanë reflektim verbues. **Përmes Raportit, MKPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve**

<sup>5</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, paragrafët 1 dhe 2.

<sup>6</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 40.

<sup>7</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 22.

<sup>8</sup> Rregullat Evropiane të Burgjeve, rregullat 22.1 deri 22.6.

<sup>9</sup> Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë për së paku dy orë shëtitjeje.

kompetente që të vepronin për ta evituar këtë mangësi. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga drejtori se është nënshkruar kontrata për t'i filluar punimet me qëllim të evitimit të kësaj mangësie.

14. Përmes Raportit, MKPT-ja dëshiron ta tërheqë vëmendjen e autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës tek Raporti i KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, i cili ishte publikuar në shtator të vitit 2016<sup>10</sup>, përmes të cilit KPT-ja, përveç konstatimeve, autoriteteve kompetente u kishte dërguar rekomandime konkrete lidhur me regjimin në BSL.
15. Përmes këtij raporti, KPT-ja kishte shprehur shqetësimin serioz lidhur me regjimin, i cili u ofrohej shumicës së të burgosurve në BSL. Në këtë raport KPT-ja kishte theksuar: *“Ofrimi i aktiviteteve konkrete për të burgosurit është i rëndësishëm thelbësor për mirëqenien dhe risocializimin e çdo të burgosuri.”*
16. KPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës si në vijim: *“Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa me prioritet për të zhvilluar dhe zbatuar një regjim gjithëpërfshirës të aktiviteteve jashtë qelisë për të gjithë të dënuarit në Burgun e Sigurisë së Lartë. Qëllimi do të duhej të ishte që të gjithë të burgosurit të kenë të drejtë të kalojnë një kohë të arsyeshme të ditës jashtë qelive të tyre, të angazhuar në aktivitete të qëllimshme të natyrave të ndryshme (punë, mundësisht me vlerë profesionale, edukim, sport, rekreacion/asociim). Kujdes i veçantë duhet tu kushtohet në këtë kontekst gjendjes së të burgosurve me dënime afatgjata.”*
17. Në përgjigjen e tyre lidhur me këtë rekomandim dërguar KPT-së, autoritetet e Republikës së Kosovës kishin theksuar si në vijim: *“Një nga synimet e SCA në planin strategjik 2016-2020 është zgjerimi i aktiviteteve të të burgosurve, veçanërisht në rastin e atyre me dënime afatgjata.”*<sup>11</sup> Prandaj, MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që të veprojnë në frymën e rekomandimit të lartpërmendur, standardet nacionale dhe ndërkombëtare të cilat kërkojnë zhvillim të programeve sa më gjithëpërfshirëse për të burgosurit, përmes të cilave synohet risocializimi dhe ofrimi i aktiviteteve konkrete jashtë qelisë.
18. Në rastin e të paraburgosurve, angazhimi i tyre në punë varet nga leja e gjykatës. MKPT-ja vëren se, sa i përket angazhimit në punë të të paraburgosurit, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”*
19. Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë përcakton si në vijim: *“I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës, pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.”*

<sup>10</sup> Raporti i KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, publikuar më 8 shtator 2016, paragrafi 45. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

<sup>11</sup> Përgjigjja dërguar KPT-së në gjuhën angleze, paragrafi 45. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1eff>.

20. Po ashtu, Rregullat e Mandelës përcaktojnë të drejtën e të paraburgosurit për të punuar. Në Rregullin 116 të Rregullave të Mandelës shprehimisht theksohet: *“Të paraburgosurit duhet ti ofrohet mundësia të punojë, por nuk duhet ti kërkohet të punojë. Nëse ai/ajo përcaktohet që të punojë, ai/ajo duhet të paguhet.”*
21. Në Raportin e KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, i cili ishte publikuar në vitin 2016, KPT-ja, lidhur me regjimin për të paraburgosurit në Qendrat e Paraburgimit në Kosovë, kishte shprehur shqetësimin se, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve, të paraburgosurit shumicën e kohës e kalojnë në qelitë e tyre, përveç dy orë shëtitjeje brenda ditës, duke shikuar TV dhe duke luajtur me letra.
22. Përmes këtij raporti, KPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente në Republikën e Kosovës si në vijim: *“KPT, ri-përsërit rekomandimin që autoritetet të angazhohen që të rrisin aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në të gjitha institucionet të cilat KPT i vizitoi, dhe në të gjitha institucionet tjera të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ku një gjë e tillë është e përshtatshme.”* Më tej KPT-ja kishte theksuar: *“Sa më e gjatë që është periudha e paraburgimit, aq më shumë duhet të zhvillohet regjimi i cili u ofrohet atyre. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që edhe numri i personelit, ku një gjë e tillë është e nevojshme, të rritet.”*<sup>12</sup>
23. MKPT-ja konsideron se, bazuar në legjislacionin në fuqi, Rregullat e Mandelës dhe rekomandimet e KPT-së, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

#### **Kujdesi shëndetësor**

24. Neni 4 i Ligjit nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton të drejtën e të personit të dënuar që t'i gëzojë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në dispozicion në komunitet. Personi i dënuar ka qasje në shërbimet e nevojshme shëndetësore pa pagesë.
25. Personeli i njësisë shëndetësore në BSL përbëhet prej tre mjekëve të rregullt, të cilët punojnë me ndërrime dhe mbulojnë edhe vikendet, një kryeinfermiere dhe pesë infermierë, të cilët punojnë në ndërrime 12 orësh. Shërbimet stomatologjike ofrohen nga stomatologu, dy herë brenda javës, ofrohen konsulta nga psikiatri, nga kardiologu dhe nga kirurgu. Në kuadër të njësisë shëndetësore punon edhe psikologu i rregullt.
26. Shërbimet tjera mjekësore, sipas nevojës dhe rekomandimit të mjekut, ofrohen edhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Të gjitha shërbimet mjekësore ofrohen sipas protokolleve dhe Praktikës Standarde të Veprimit. Njësia shëndetësore mban protokollin si në vijim: Protokollin e vetëlëndimeve, i tentim-vetëvrasjeve, i grevave të urisë, i vetmisë, i vdekjes në burg, i abuzimeve seksuale dhe i lëndime trupore. Në kuadër të njësisë shëndetësore u funksionalizua laboratorin dhe po trajnohen dy infermierë për këto shërbime.

#### **Kushtet fizike në njësinë shëndetësore të BSL-së**

27. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se kushtet fizike në një pjesë të njësisë shëndetësore nuk janë të mira, për shkak të dëmtimeve të dyshemeve. Në katin ku është e vendosur

<sup>12</sup> Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, publikuar në shtator 2016, paragrafi 46. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

stomatologjia punohet në kushte të vështira, pasi që ka material ndërtimor kudo përreth dhe pluhur. Dhomat e qëndrimit nuk janë funksionale dhe janë në të njëjtin kat ku është ordinanca stomatologjike.

28. Njësia shëndetësore ka shok terapinë, bombol me oksigjen, EKG, ndihmën e parë, tubin laringal, tensimetrin, elektroshokun, instrumente kirurgjike etj., si dhe materialin shpenzues për trajtim të plagëve. **MKPT-ja nuk mori ankesa sa u përket shërbimeve të ofruara mjekësore. Përkundrazi, të burgosurit u shprehën në favor të trajtimit shumë të mirë mjekësor dhe respektimit të dinjitetit të të burgosurve.**

### **Rëndësia e kontroleve mjekësore të të burgosurve të sapopranuar**

29. KPT-ja dhe aktet tjera juridike ndërkombëtare vazhdimisht theksojnë rëndësinë e kontrollimit mjekësor të të burgosurve të sapopranuar, veçanërisht në institucionet të cilat përbëjnë pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një kontrollim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
30. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut mund të japin kontribut domethënës në parandalimin e keqtrajtimit fizik, gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënës, në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.<sup>13</sup>
31. LESP-ja<sup>14</sup> dhe Praktika Standarde e Veprimeve<sup>15</sup> e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollimit mjekësor brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit.
32. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>16</sup>, Rregullat Evropiane të Burgjeve<sup>17</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>18</sup>
33. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant mjekësor, të burgosurit e sapopranuar kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh, nga momenti i arritjes në BSL.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

34. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit<sup>19</sup>, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; me LESP-në<sup>20</sup>; me standardet e

<sup>13</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

<sup>14</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

<sup>15</sup> Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

<sup>16</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>17</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

<sup>18</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).

<sup>19</sup> Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

KPT-së;<sup>21</sup> si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>22</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>23</sup>

35. Për më shumë, edhe standardet e KPT-së po ashtu përcaktojnë se të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve duhet të kryhen ashtu që të mos shihen dhe të mos dëgjohen nga zyrtarët korrektues, përveç në rastet kur mjeku e kërkon një gjë të tillë.
36. Po ashtu, neni 25, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, shprehimisht përcakton: *“Mjeku bënë vizitën mjekësore në kushte të konfidencialitetit mjekësor dhe normave etike profesionale.”*
37. Bazuar në informatat e stafit të shërbimit shëndetësor dhe në intervistat me të burgosurit, shërbimet shëndetësore, në përgjithësi, jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues.

### **Çështje të tjera**

38. Gjatë vizitës në BSL, MKPT-ja mori disa ankesa nga të parburgosurit e përkatësisë etnike serbe se jo të gjitha dokumentet u jepen të përkthyer në gjuhën serbe.
39. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet ta kenë parasysh obligimin ligjor që këto shërbime të ofrohen në gjuhët zyrtare të vendit, ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë dhe me legjislacionin relevant që e rregullon këtë çështje.

### **Incidentet ndërmjet të të burgosurve**

40. MKPT-ja vërejtë se incidentet ndërmjet të të burgosurve nuk janë problem madhor në BSL, edhe pse ka pasur incidente gjatë këtij viti. Bazuar në pohimet e të burgosurve të përfshirë në incidente, në dokumentacionin mjekësor dhe administrativ, autoritetet e BSL-së i kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, të parapara me ligj, për t'i parandaluar incidentet dhe për t'i mbrojtur të burgosurit.

### **Masat disiplinore**

41. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: Qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.<sup>24</sup> Ndërsa në rastet e të parburgosurve mund të shqiptohen dënimet si në vijim: Kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike.
42. MKPT-ja në raportet e mëhershme ka shprehur shqetësimin për faktin se legjislacioni në fuqi<sup>25</sup> parasheh që, para se i burgosuri të vendoset në vetmi, drejtori i institucionit korrektues të kërkojë me shkrim mendimin e mjekut, i cili dëshmon se i dënuari është në gjendje të mirë shëndetësore fizike dhe psikike për t'iu nënshtruar masës disiplinore të vetmisë.

---

<sup>20</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

<sup>21</sup> Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

<sup>22</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>23</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).

<sup>24</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>25</sup> Neni 107 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe neni 76 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.



43. Një veprim i tillë nuk përcaktohet me Praktikën Standarde të Veprimit e DShB-së dhe personeli shëndetësor nuk jep mendime me shkrim nëse i burgosuri, të cilit i shqiptohet kjo masë disiplinore, është në gjendje fizike dhe psikike për t'iu nënshtuar masës disiplinore të vetmisë.
44. Gjatë vizitës në BSL, MKPT-ja intervistoi disa të burgosur, të cilët ishin ndëshkuar me masën disiplinore të vetmisë. Pas intervistimit të të burgosurve dhe shqyrtimit të dokumentacionit administrativ dhe mjekësor, MKPT-ja konstatoi se të gjitha të drejtat e tyre, të cilat garantohen me LESP dhe me standarde ndërkombëtare, janë respektuar dhe janë përfillur procedurat e parapara me LESP dhe me aktet tjera nën ligjore.

### **Kontakti me botën e jashtme**

45. Legjislacioni në fuqi<sup>26</sup>, në rastet e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat minimum një orë, si dhe për vizitë nga fëmijët dhe nga bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë thirrje telefonike.
46. Lidhur me thirrjet telefonike, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese<sup>27</sup> përcakton se i dënuari ka të drejtë për biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe e personit të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë minuta).
47. Në BSL të burgosurve në regjimin e avancuar u lejohen 3 telefonata në javë nga 15 minuta, 2 vizita familjare në muaj, të cilat zgjasin 1 orë, çdo 2 muaj lejohet vizita e lirë e cila zgjat 3 orë.
48. Në rastet e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita *brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*, bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Bazuar në intervistat me të paraburgosurit, del se atyre u mundësohen dy vizita në muaj, sipas lejes së gjykatës.
49. Në rastet e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që, me shkrim ose me gojë, të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike apo me zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai/ajo.<sup>28</sup> MKPT-ja ka intervistuar një shtetas të huaj dhe nuk mori ankesa sa i përket respektimit të të drejtave të lartpërmendura.

### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

50. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut, apo brenda qendrës së paraburgimit ku vendosen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

<sup>26</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

<sup>27</sup> Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

<sup>28</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33, paragrafi 1.

51. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministria e Drejtësisë.<sup>29</sup>
52. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues ose të personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen MKPT-së së Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.
53. Po ashtu, BSL, bazuar në marrëveshjet me ministritë kompetente, mund të vizitohet nga organizatat joqeveritare.
54. MKPT-ja vërejtë se në dispozicion të të burgosurve në BSL janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e ankesave të vendosura nga DShB-ja dhe kutitë e ankesave të vendosura nga IAP-ja. Kutitë e ankesave të vendosura nga IAP-ja mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa sa i përket respektimit të kësaj të drejte.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

#### REKOMANDON

##### Ministritë së Drejtësisë:

- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të ndërmerren hapat e duhur për ta sanuar dëmtimin e dysHEMEVE në stacionarë dhe në pavijonet e BSL-së ku ato janë dëmtuar.
- MKPT ripërsërit rekomandimin që të evitohet mangësia sa i përket ngjyrës së bardhë reflektuese, e cila është pengesë për aktivitete jashtë qelive.
- Të ndërmerren veprime për ta zhvilluar dhe për ta zbatuar një regjim gjithëpërfshirës të aktiviteteve jashtë qelisë për të gjithë të burgosurit.

<sup>29</sup> Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: "Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim."

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit